



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

**PROPOZIM**

**PËR:**

**“Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Elton Bepin Frashnaj”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49,pika 1,2,3, neni 54,germa j, si dhe në vendimin nr.09 datë 03.02.2026 i KQZ, komisioni i mandateve i Këshillit Bashkiak Vau Dejës propozon :

I.Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës,Z.Elton Bepin Frashnaj, propozuar nga subjekti politik,Partia Socialdemokrate e Shqipërisë,si pasojë e vakancës së krijuar nga Z.Aleko Mark Dodani.

**Komisioni i Mandateve:**

Z. Neki Kapllanaj – Kryetar

Z. Marin Dodaj – Sekretar

Znj.Edona Molla – Anëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 23.02.2026**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026

**Analiza ligjore:**

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar; Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.01, datë 29.01.2026, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr.87/1 prot, datë 09.02.2026.

**Situata financiare :** Projekt vendimi propozon që 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Janar 2026 familje 127, me 398,942 lekë, me 5.98 % e fondit total. 2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Janar 2026 janë shpallur fitues, 861 familje, me fond 6,656,296lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 399,377 lekë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe PAK kane relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 23/02/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.03 datë 11/02/2026, relacionit e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026" paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

### VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi \_\_\_\_\_ Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj \_\_\_\_\_ Zv.Kryetar i komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja \_\_\_\_\_ Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit  
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 23.02.2026**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025 "Miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës".

**Analiza ligjore:**

Mbështetur në nenin 9 pika" 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligjin 87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026 dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës.

**Situata aktuale e funksionit:** Ndryshimet që propozohen janë të gjitha në rritje të zerave të investimeve që janë pjesë e projekteve prioritare për vitet 2026-2028, dhe në pakesim të zerave që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitet 2026-2028. Në zbritje do të preken zera të trashëguar nga vitet e kaluara, kryesisht mbetje të akumuara në vite, dhe që janë realizuar pjesësisht si shpenzim, dhe nuk kanë arsye të jenë pjesë e buxhetit me ato vlera. Pra këto veprime janë të mundura në këtë moment, me realizimin e trashëgimit të fondeve buxhetore dhe cash nga viti 2025. Po ashtu duke u nisur nga shkresa Nr 878 Prot datë 12.02.2026 e Drejtorisë së Menaxhimit të Pyjeve, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit drejtuar Sektorit të Buxhetit dhe Financës me lëndë "Kërkesë për hartim plane Mbarështimi të Pyjeve dhe Kullotave" jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore për diferencën e vlerës së padisponueshme aktualisht në këtë program për këtë zë investimi.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 74 datë 23.12.2025 "Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

afatmesëm perfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me 884/1 prot datë 07.01.2026, duke plotësuar nevojat e bashkise Vau Dejës.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,  
Komisioni me shumicë votash,

## VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

<b>Neki Kapllani</b> <i>(emri, mbiemri, firma)</i>	<b>Kryetar i Komisionit</b>
<b>Arsen Mehmeti</b> <i>(emri, mbiemri, firma)</i>	<b>Zv.Kryetar i komisionit</b>
<b>Florin Tanushi</b> <i>(emri, mbiemri, firma)</i>	<b>Sekretar i Komisionit</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit  
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 23.02.2026**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për ndryshimin e Vkb nr.73 datë 23.12.2025 "Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026".

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 53 dhe nenit 54 shkronja "c", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, në Ligjin Nr 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligji 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil të ndryshuar; Vendim nr 425, datë 26.06.2024 për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimitorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, VKM nr 776 datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendim nr.104, datë 11.2.2026 Për një ndryshim në vendimin nr. 419, datë 26.6.2024 të këshillit të ministrave, "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Vendim nr. 87, datë 6.2.2026 Për disa ndryshime në vendimin nr. 326 datë 31.5.2023 të këshillit të ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, Vendim nr. 103, datë 11.2.2026 për disa ndryshime në vendimin nr 328 datë 31.05.2023 të këshillit të ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kuljve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë

**Situata aktuale e funksionit:** Ndryshimi i nivelit të pagave për punonjësit e Administratës së Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026:

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisioni.

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 73 datë 24.12.2025 "Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nëpunësit civil dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026 dhe Shprehje Ligjshëmërie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 883/1 de 09.01.2026.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,  
Komisioni me shumicë votash,

## VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

**Neki Kapllani** \_\_\_\_\_ Kryetar i Komisionit

*(emri, mbiemri, firma)*

**Arsen Mehmeti** \_\_\_\_\_ Zv.Kryetar i komisionit

*(emri, mbiemri, firma)*

**Florin Tanushi** \_\_\_\_\_ Sekretar i Komisionit

*(emri, mbiemri, firma)*



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 23.02.2026

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit pranimin e të moshuares Znj..Mrike Doda në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

**Analiza ligjore:**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar në VKM-në 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" Kreu III Pika 13. A): pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a): pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

**Situata aktuale e funksionit:** Mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social. Bashkia Vau Dejës të zj.Mrike Doda për sistemimin e saj në qendren për të moshuar "BESA" Barbullush, ju paraqesim propozimin tonë për miratim. Zj. Mrike Doda është shprehur jeton vetem ne nje banese me qira dhe perballat me vështiresi në permbushjen e nevojave te perditshme.E moshuara Mrika Doda, paraqet kërkesë për akomodim në shërbim rezidencial (azil), për shkak të mungesës së mbështetjes familjare të vazhdueshme dhe pamundësisë për vetë-kujdes. Duke marrë parasysh moshen gjendjen shendetsore, vetmine dhe mungesen e kujdesit familjar, prpzoheet akomodimi i tij ne Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush" ku do mund te marre perkujdesjen e nevojshme, sherbimet baze te jetetses, ndihmen mjeksore dhe mbeshtetje sociale te vazhdueshme.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:** Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për të moshuarit

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk është objekt i konsultimit publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 23/02/2025, shqyrtoi projekt vendimin "Për pranimin e të moshuarës zj. Mrike Doda në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush,

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

### VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

**Albina Livadhi** \_\_\_\_\_ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

**Meliha Zyberaj** \_\_\_\_\_ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

**Sanije Salja** \_\_\_\_\_ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 23.02.2026

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit "Subvencionit të qirasë në tregun e lirë".

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, nenit 38 i Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot. datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM-së nr.362 prot. datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 "Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026" në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencion i qirasë në tregun e lirë"; VKB Nr.57 dt. 27.10.2025, "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025, VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit" VKB nr. 47. datë 26.06.2024 "Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave". Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 16.02.2026.

**Situata aktuale e funksionit:** Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.57 dt.27.10.2025, "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025, VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit", realizoi mbledhjen në datën 16.02.2026. Ku u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe kontratës së qirasë noteriale për banorën Tone Pjetraj. Nga vlersimi social ekonomik vërehet se kjo banorë është e pastreh jeton e vetme, pa të ardhura vetem Ndihma Ekonomike dhe si rrjedhojë nuk mund të perballojë një shtëpi me qira, si dhe shpenzimet jetike. Komisioni i strehimit e shikoj të arsyeshme për asistuar si përfitues të programit të strehimit subvencionit të qirasë në tregun e lirë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:** Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Impakti social / grupet që preken:** Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 23/02/2025, shqyrtoi projekt vendimin “Për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

## VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

**Albina Livadhi** \_\_\_\_\_ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

**Meliha Zyberaj** \_\_\_\_\_ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

**Saniye Salja** \_\_\_\_\_ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)